

ART EXPLORA FESTIVAL



CULTURAL
ODYSSEY IN THE
MEDITERRANEAN SEA

FESTIVALI ART EXPLORA

BROSHURA EDUKATIVE

Si pjesë e ekspozitës gjithëpërfshirëse të Art Explora Festival (Festivali Art Explora), po u japim mësuesve, profesionistëve të arsimit dhe vullnetarëve një paketë mësimore për t'i ndihmuar që ta kenë si bazë për vizitën e tyre.

Kjo paketë jep shpjegimet kryesore për të kuptuar përmbajtjen e vizitës, si dhe hollësitë për disa prej veprave të ekspozuara, duke i dhënë mundësi lexuesit të përgatisë itinerarin e vet dhe të ndërtojë aktivitete të përshtatshme për të gjithë vizitorët.

Përmbajtja

PREZANTIMI I PROJEKTIT ART EXPLORA FESTIVAL	4
PREZANTIMI I MUZEUT TË LUVRIT	5
PREZANTIMI I BROSHURËS EDUKATIVE	6
TEMAT PËR REFLEKTIM	7
1. MESOPOTAMIA, DJEPI I QYTETËRIMIT	8
• Shpikja e qyteteve dhe e shkrimit	11
• Shkrimi si mjet i bashkimit të popujve	11
2. SHPIKJA E PAPIRUSIT DHE PËRDORIMET E TIJ TË NDRYSHME NË LASHTËSI	13
• Paraqitja e muzikës në artin e lashtë	16
• Nga e qeshura në të qarë: shprehja e emocioneve	17
3. GRATË NË EGJIPTIN E LASHTË, MIDIS NËNSHTRIMIT DHE LIRISË	20
• Adhurueset Hyjnore, garantueset e pushtetit të faraonit	23
• Pozicioni i grave në çiftet e pasura	24
4. QYTETËRIMI ETRUSK: NJË PORTË KULTURORE	26
• Një rol më i madh për gratë etruske	29
• Trashëgimia etruske në kulturën romake	30
5. ORIGJINAT E SKULPTURAVE GREKE	33
• Mitet dhe figurat femërore	36
• Ngjyra në artin e lashtë: zbukurimi i statujave dhe individëve	37
6. PELLGU I MESDHEUT, TOKA E PUSHTIMEVE, ALEANCAVE DHE SHKËMBIMEVE	40
• Përplasjet që nxisin takimet	43
• Mesdheu nën sundimin romak	44
FJALORI	46

PREZANTIMI I PROJEKTIT ART EXPLORA FESTIVAL

Eksperienca gjithëpërfshirëse që do të shijoni është pjesë e **Art Explora Festival (Festivali Art Explora)**, që organizohet nga fondacioni me të njëjtin emër. **Ai është një festival kulturor shëtitës** që ofron eksperienca pa pagesë, të realizueshme dhe unike për të gjitha audiencat **në bordin e anijes-muze të parë në botë** si dhe në molet dhe qytetet mikpritëse.

Me mbështetjen e UNESCO-s, festivali dhe anija-muze e tij do të udhëtojnë për 2 vite, nga pranvera 2024 deri në pranverën 2026, **në mbi 15 shtete në Mesdhe**, duke filluar me qytetin e Valetës në Maltë. Lista e shteteve pjesëmarrëse përfshin **Francën, Italinë, Kroacinë, Shqipërinë, Greqinë, Turqinë, Qipron, Libanin, Egjiptin, Maltën, Tunizinë, Algjerinë, Marokun, Spanjën dhe Portugalinë**. Festivali do të bëjë një deri në dy ndalesa në çdo shtet, duke udhëtuar midis porteve me madhësi të ndryshme dhe me rrethana sociale dhe përbërje demografike të shumëllojshme.

Në mënyrë që të mbështesë dialogun në shkallë të gjerë për **problemet bashkëkohore** që kanë vendet ku janë portet e ndryshme ku do të ndalojë, Art Explora Festival do të bëjë bashkë **artistë, një ekip kuratorësh bashkëpunues, organizata kulturore dhe edukative, në lidhje me kuptimin reciprok të një trashëgimie të përbashkët**, ruajtjen e mjedisit, si dhe promovimin e territoreve dhe të trashëgimisë kulturore.



Anija-muze

A E DINI?

Përveç ekspozitës gjithëpërfshirëse në bordin e anijes, Art Explora Festival i vendos gratë në ballë për t'u dhënë atyre mundësinë të shprehen dhe për të theksuar ndikimin e tyre në shoqërinë tonë: **66% e kuratorëve të ekspozitës janë gra, siç janë shumica e artistëve veprat e të cilëve po ekspozohen.**

PREZANTIMI I MUZEUT TË LUVRIT

Duke qenë një partner i privilegjuar i **Art Explora Festival**, Muzeu i Luvrit do të prezantojë një ekspozitë gjithëpërfshirëse me titull **"E tashmja! Imazhet, ligjërimet dhe paraqitjet e grave në Mesdhe"**.

Kjo ekspozitë ofron një **pasqyrim të rolit dhe paraqitjes së figurave femërore në botën mesdhetare**, nëpërmjet një **eksperience edukative dhe ndijore**, në bazë të **teknologjive audiovizuale dixhitale**.

Kjo eksperiencë gjithëpërfshirëse u zhvillua nga një **ekip kuratorësh bashkëpunues** i përbërë nga figura të shquara, artistë dhe mendimtarë, duke përfshirë: **Sidi Larbi Cherkaoui** (koreograf), **Noëmi Daucé** (kurator në Departamentin e Antikiteteve të Lindjes së Afërt në Muzeun e Luvrit), **Simone Fattal** (artist), **Nicolas Saada** (drejtor filmi) dhe **Daniel Mendelsohn** (shkrimtar). Secili nga këta individë ka mendime të integruara historike dhe bashkëkohore për jetët e mesdhetarëve në studimet e tyre.

ÇFARË ËSHTË MUZEU I LUVRIT?

Është muzeu më i vjetër dhe më i madh në Francë dhe muzeu i dytë më i madh në botë pas muzeut Hermitage (Hermitazh) në Shën Pjetërburg (Rusi). **I ndërtuar fillimisht si kështjellë mesjetare në fund të shekullit të 12-të** me kërkesë të Mbretit të Francës, Filip August (1165-1223), Luvri u bë **me kalimin e kohës pallati i monarkëve francezë** (midis të tjerëve ishin Fransua I, Henri IV dhe Luigji XIV), dhe më pas u bë **muze kombëtar në vitin 1793**, pak pas Revolucionit Francez (1789).

Me një sipërfaqe ekspozimi **73 000 m²** (e mjaftueshme për të nxënë 10 stadione futbolli) dhe mikpritës i mesatarisht **9 deri në 10 milionë njerëzve çdo vit**, Muzeu i Luvrit konsiderohet një muze universal. Me fjalë të tjera, ai synon të ofrojë një **pasqyrë të përgjithshme të të gjithë prodhimit artistik të njerëzimit**, nga periudha prehistorike (vepra më e vjetër e muzeut, statuja e Ain Ghazal, është gati 9000-vjeçare) deri në vitin 1848.

KOLEKSIONET E LUVRIT

Për t'i ekspozuar sa më mirë **35 000 veprat** e të gjitha llojeve dhe nga të gjitha zonat gjeografike, Muzeu i Luvrit është i ndarë në **8 departamente kuratoriale**. Veprat që do të shikoni në ekspozitën gjithëpërfshirëse vijnë kryesisht nga departamentet e mëposhtme: **Antikitetet Greke, Etruske dhe Romake, Antikitetet Egjiptiane, Antikitetet e Lindjes së Afërt dhe Pikturat**.

PREZANTIMI I BROSHURËS EDUKATIVE

Paketa mësimore është planifikuar për të dhënë **shpjegimet kryesore për ta kuptuar** që të përgatiteni për vizitën, bazuar në përzgjedhjen e veprave të ekspozuara në ekspozitën gjithëpërfshirëse. Meqenëse ekspozita është planifikuar si një udhëtim nëpër koleksionet e Luvrit, përdorimi i këtij dokumenti do t'u japë mundësi studentëve të njihen me veprat që do të mund t'i identifikojnë dhe t'i njohin gjatë vizitës së tyre.

Gjithsej, janë zgjedhur dhe diskutuar gjashtë vepra "kryesore" nga Muzeu i Luvrit, të cilat trajtojnë temat e mëposhtme:

- Mesopotamia, djepi i qytetërimit
- Shpikja e papirusit dhe përdorimet e tij të ndryshme në antikitet
- Gratë në Egjiptin e lashtë, midis nënshtrimit dhe lirisë
- Qytetërimi etrusk: një portë kulturore
- Origjinat e skulpturës greke
- Pellgu i Mesdheut, toka e pushtimeve, aleancave dhe shkëmbimeve

Këto tema paraqiten në renditje kronologjike, duke filluar me qytetërimet më të vjetra mesdhetare dhe duke përfunduar me pushtimin romak.

Përveç kësaj, veprat kryesore krahasohen me veprat e tjera nga Luvri **përtë ilustruar pasurinë e temës dhe për të hequr vija paralele me veprat nga periudhat e tjera ose zonat gjeografike mesdhetare**. Këto vepra, të cilat vijnë nga disa rajone të Pellgut të Mesdheut (Palmira, Biblos, Memfis, Tebë, Çerveteri, Athinë etj.), **ilustrojnë vazhdimësinë e shkëmbimeve ekonomike, kulturore, politike, diplomatike dhe të shkëmbimeve të tjera në Mesdhe, të paktën që nga antikiteti**.

Me gratë (të vërteta ose hyjnore) si figura qendrore, veprat e zgjedhura paraqesin, Enheduanën, poeteshën e parë në historinë e njerëzimit (shekulli i 23-të p.e.s.) dhe poeteshën e njohur greke Sapfo (shekulli i 7-të dhe i 6-të p.e.s), perandoreshat Livia dhe Julia Domna, figurat mitologjike Medea, Leda dhe Evropa, si dhe jetën e përditshme të grave (priftëreshave, bashkëshorteve etj.).

Në fund, në të gjithë paketën mësimore, do të gjeni aktivitete mësimore për t'ua caktuar grupeve tuaja, duke përfshirë një listë të pajisjeve të nevojshme, në mënyrë që të plotësoni vizitën në ekspozitën gjithëpërfshirëse. Përveç kësaj, në fund të prezantimit të çdo vepre, **seksionet "Eksploro më tej" japin perspektivat për shembujt pak a shumë bashkëkohorë** (letërsi, muzikë, poezi, arte pamore etj.), në mënyrë që të tregojnë se veprat e ekspozuara vazhdojnë të jenë edhe sot të përshtatshme, ndërsa seksioni **fjalori** do të ndihmojë për t'i shpjeguar klasës suaj disa nga temat e përdorur.

Temat për reflektim

1. MESOPOTAMIA, DJEPI I QYTETËRIMIT

2. SHPIKJA E PAPIRUSIT
DHE PËRDORIMET E TIJ TË NDRYSHME
NË ANTIKITET

3. GRATË NË EGJIPTIN E LASHTË,
MIDIS NËNSHTRIMIT DHE LIRISË

4. QYTETËRIMI ETRUSK: NJË PORTË KULTURORE


5. ORIGJINAT E SKULPTURËS GREKE

6. PELLGU I MESDHEUT,
TOKA E PUSHTIMEVE,
ALEANCAVE DHE SHKËMBIMEVE

1. MESOPOTAMIA, DJEPI I QYTETËRIMIT

Pllaka e shkrimit e Enheduanës





Harta e Mesopotamisë ©Marie D'agostino

E ndodhur kryesisht në **Irakun e sotëm, Mesopotamia** (fjalë për fjalë "vendi midis lumenjve") konsiderohet **djepi i njerëzimit, ekonomisë dhe shkrimit**. Ishte me të vërtetë në këtë pjesë të botës, ku në fund të mijëvjeçarit të katërt p.e.s., **u shfaqën qytetet (qytet-shtetet*) e para, si dhe sistemet më të vjetra politike dhe administrative të njerëzimit**. Historia e kësaj periudhe kritike njihet falë **pllakave të shkrimit kunjor**, një numër i të cilave janë ekspozuar në Muzeun e Luvrit.

A E DINI?

Të krijuara nga **sumerianët***, **pllakat e shkrimit kunjor** ishin **pllaka balte ku mbishkruhej duke përdorur një penë prej kallami** (kallam i mprehur). Për shkak të formës si pykë të shkronjave të këtij sistemi shkrimor, i cili është **më i vjetri në histori**, historianët e quajtnë "kunjor", i cili i referohet shkrimit të përbërë nga elemente në formë pyke.

PREZANTIMI I VEPRËS NR. 1:

Pllaka e shkrimit e Enheduannës



Në Departamentin e Antikiteteve të Lindjes së Afërt, Muzeu i Luvrit ka strehuar një **pllakë shkrimi prej balte** (Fig. 1) që është vetëm rreth 10 cm e lartë. Ajo dëshmon **shprehjen e rrallë të Enheduannës** (2286–2251 p.e.s.), **poetes së parë në historinë e njerëzimit**, një priftëreshë e lartë* që i kushtojë kultit të Sinit* në qytet-shtetin e Urit*.

Një bijë mbreti, Enheduana konsiderohet si **shkrimtarja më e hershme e njohur në histori**. Si një princeshë e rangut të lartë, ajo kompozoi **disa himne hyjnore**, nga të cilat rreth 40 deri më sot i janë atribuar asaj dhe të cilat lavdërojnë perënditë ose ndajnë momente nga jeta e saj. Këtu, ajo ia kushton himnin e saj Inanës ose Ishtarit, perëndeshës së dashurisë dhe të luftës.

(Fig. 1) *Tablet of Enheduanna (Pllakë shkrimi e Enheduannës)*, Irak, 1894–1595 p.e.s., baltë, H. 10,6 cm x Gj. 5,8 cm x Th. 3,1 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

AUTOBIOGRAFIA E PARË?

Ky tekst i shkëputur është **shprehja e parë e një autobiografie* prekëse** (është përdorimi i parë i përemrit vetor "unë") **përtej entuziazmit të saj fetar**. Enheduana sjell ndërmend mërgimin e saj, pendesën e saj dhe **humbjen e funksioneve të saj priftërore*** në një formë metaforike*. Në të vërtetë, pas vdekjes së babait të saj, Enheduana e kishte humbur pozicionin e saj si priftëreshë e lartë. **Kjo është arsyeja pse ajo vendosi të kërkojë ndihmën e perëndeshës Inana (ose Ishtar) me këtë himn.**

SHPIKJA E QYTETEVE DHE E SHKRIMIT



Këtu shikojmë një pllakë tjetër shkrimi mesopotamike (Fig. 2), e cila dëshmon faktin se, që nga mijëvjeçari i dytë p.e.s., **shkrimi kishte nisur të bëhej një mjet tregimtarie**. Para kësaj periudhe, ai përdorej thjesht si mjet për llogaritje (për të llogaritur shitjet ose mallrat etj.) Në këtë pllakë shkrimi është shkruar një histori rreth perëndive **Enki*** dhe **Ninmah***, të cilët ishin rebeluar ndaj punës së tyre pa mirënjohje të pastrimit të lumenjve dhe kanaleve.

(Fig. 2) *Miti sumerian i krijimit të njeriut, duke përfshirë muzikantët*, Irak, 1800–1700 p.e.s., baltë, L. 14,3 cm x Gj. 10,8 cm x Th. 3,7 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

SHKRIMI SI MJET I BASHKIMIT TË POPUJVE



Këtu është e pikturuar një stelë me një imazh të **Ishtarit** (Fig. 3) (perëndeshë akadiane*), e cila gradualisht filloi të lidhej me perëndeshën sumeriane **Inana**. Prandaj kjo stelë ilustron **bashkimin e kulturave dhe procesin e asimilimit***, sidomos duke ndarë të njëjtin shkrim. Në të vërtetë, **ndodh që në mitologjinë sumeriane, një perëndeshë e vetme të ketë dy emra të ndryshëm, ndërkohë që ka të njëjtat funksione**, siç tregohet nga Ishtari dhe Inana, **të cilat janë të dyja perëndesha të dashurisë dhe të luftës**.

(Fig. 3) *Ishtar of Arbela (Ishtari i Arbelës*)*, Siri, midis shekujve të 9-të dhe të 7-të p.e.s., gur, L. 121 cm x Gj. 82 cm x Th. 30 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.



(Fig. 4) *Mattei Athena (Athina Matei)*, Itali, 130–90 p.e.s., mermer, L. 230 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.



(Fig. 5) *Aphrodite (Afërdita)*, Itali, 25–50 e.s., mermer, L. 149 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

Këto dy statuja të perëndeshave greko-romake tregojnë se si u asimiluan figurat fetare mesopotamike të lashta, të lartpërmendura (Inana/Ishtari) nga kulturat greko-romake, në të cilat këtyre hyjnive u ishin dhënë të njëjtat attribute dhe gjini, megjithëse emri dhe pamja e tyre ndryshonte. Në fakt, pikërisht nga Ishtari dhe Inana, perëndeshat mesopotamike të dashurisë dhe luftës, grekët dhe romakët rrodhën perëndeshat **Afërdita** (perëndesha e dashurisë) dhe **Athina** (perëndesha e luftës).

EKSPLORONI MË TEJ

Për të eksploruar më tej, mund të përdorni shembujt e mëposhtëm si pika fillestare (me mundësinë për të kërkuar referenca të tjera në klasë):

MAY ZIADÉ

May Ziadé (1886-1940) ishte një shkrimtare, poete dhe eseiste libanezo-palestineze. **Si pioniere e feminizmit lindor dhe e ringjalljes së letërsisë arabe**, temat e saj të preferuara ishin malli, frika për kohën që kalonte dhe melankolia.

- Mund të lexoni në klasë një fragment nga "Tristesse" ("Trishtim"), një poemë nga përmbledhja e saj "Fleurs de rêve" ("Lulet e një ëndrre"), e botuar në vitin 1910 me pseudonimin **Isis Copia**.

MAHMOUD DARWICH

Mahmoud Darwich (1941-2008), shkrimtar dhe poet palestinez, i njohur për veprën e tij me temën e mërgimit. Mund të lexoni në klasë një fragment nga "To My Mother" ("Nënës sime") (1966), një poemë në të cilën poeti trajton ndjenjat e tij të mallit për fëmijërinë e tij.

OROUBAH DIEB

Oroubah Dieb (lindur në vitin 1968) është një **artiste pamore siriane**, e cila është diplomuar në Institutin e Arteve të Bukura të Damaskut në vitin 1991 dhe **subjektet e përsëritura të së cilës kanë qenë mërgimi, kampet e refugjatëve, gratë dhe fëmijët, që kur u largua nga vendi i saj i lindjes për shkak të luftës**.

- Mund të tregoni në klasë një nga veprat e saj (si p.sh. "Displacement I" ["Zhvendosja I"], 2020, kolazh i përzier mediatik), dhe t'u kërkon nxënësve të përshkruajnë emocionet që ndiejnë, si dhe historinë që ka treguar artistja.


AKTIVITETI I SUGJERUAR MËSIMOR (MOSHAT 6–15 VJEÇ):

Skiconi një stelë për nder të një hyjnie të zgjedhur dhe vizatojeni atë në një format të madh, duke zbatuar karakteristikat e një stele. Si kujtesë, stela është një monument vertikal që paraqet një ose disa figura, ose nga beli e lart, ose nga maja e kokës te gishtat e këmbëve, me mbishkrime që tregojnë identitetin e tyre ose që përmbajnë lutje.

Pajisjet: Një fletë me format A4 ose A3, lapsa, lapsa me ngjyra, stilolapsa me majë shajaku

2. SHPIKJA E PAPIRUSIT DHE PËRDORIMET E TIJ TË NDRYSHME NË LASHTËSI

Partiturë nga Medea nga Karkinos i Riu në papyrus



I konsideruar **një nga mjetet më të vjetra të shkrimit për njerëzimin** dhe i përdorur për mbi 40 shekuj, papirusi u përdor jo vetëm për hieroglifet, por edhe për **shkrimin hieratik, demotik, grek, koptik, latin dhe arab**. Duke qenë një mjet shkrimi i volitshëm dhe për shkak të lehtësisë me të cilën përdorej, ai zëvendësoi pllakat e shkrimit prej balte që përdorehin në kohën e Mesopotamisë.

Papiruset* që kanë mbijetuar pasqyrojnë trashëgiminë e pasur të qytetërimeve të lashta, falë përdorimeve të tyre të shumta, duke përfshirë për tekstet ligjore dhe administrative, korrespondencën, letërsinë, enciklopeditë, himnet dhe tekstet funerare.

FJALORI I VOGËL I SISTEMEVE TË HARRUARA TË SHKRIMIT!

Hieratik: sistem i lashtë shkrimi egjiptian, i cili i lejonte shkruesit të shkruanin shpejt duke i thjeshtuar hieroglifet me përdorimin e simboleve.

Demotik: sistem shkrimi kursiv (shkrim dore me letra të bashkuara) i përdorur nga shekulli i 7-të p.e.s. në Egjipt për të thjeshtuar shkrimin hieratik.


Koptik: shkrimi dhe gjuha që rrodhën nga shkrimi demotik, duke përdorur alfabetin grek të lashtë dhe paraardhësi i gjuhës së Egjiptit të sotëm.

PREZANTIMI I VEPRËS NR. 2:

Partiturë nga Medea nga Karkinos i Riu në papirus

Me përmasa të vogla dhe i rizbuluar rreth njëzet vite më parë midis një koleksioni papirusesh me shkrim arab, koptik, demotik dhe grek, **ky është një dokument i jashtëzakonshëm për sa i përket historisë së letërsisë dhe muzikës** (Fig. 6). Ky papirus ka 22 rreshta me tekst dhe muzikë, të vizatuara me përpikëri duke përdorur një penë prej kallami shumë të hollë të zhytur në bojë karboni. **Kjo është një kopje e shkruar nga një dorë me përvojë dhe pa shkarravitje**, ndoshta nga një artist që ka bashkuar pjesë nga arie dhe bravura të mirënjohura. **Ky papirus dëshmon në këtë mënyrë praktikën e kopjimit të pjesëve nga repertorë klasikë (tekst dhe muzikë) në Egjiptin e periudhës greko-romake.**

Në këtë rast, është një fragment nga një tragjedi* **nga shekulli i 4-t p.e.s.**, me titull "Medea"* dhe i kompozuar nga **Karkinos i Riu***. Zbulimi i një papirusi muzikor është i rëndësishëm, sepse midis qindra mijëra papiruseve greke që janë regjistruar deri më sot, vetëm gati mbi njëqind janë fragmente muzikore. **Prandaj, këto partitura janë mënyra e vetme për të mësuar rreth muzikës greke në formën e saj më të prekshme, sepse nuk kemi gjetur instrumente ose traktate muzikore nga ajo kohë.**



(Fig. 6) *Partiturë nga Medea nga Karkinos i Riu në papirus*, Egjipt, 100–199 e.s., papirus, L. 13 cm x Gj. 12 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.



(Fig. 7) Papyrus letrar; Papyrusi Didot, Siri, 170–160 p.e.s., papirus, Gj. 107 cm x L. 16,7 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

Ky është një fragment i një papyrusi letrar nga **shekulli i 2-të p.e.s, i zbuluar në Memfis*** (Fig. 7). I shkruar në greqisht, ai përfshin disa fragmente nga tragjedi dhe shkrime letrare. Midis tyre janë tetë vargje nga Medea, një tragjedi nga Euripidi*, si dhe disa rreshta për mitin e rrëmbimit të Evropës*.

PARAQITJA E MUZIKËS NË ARTIN E LASHTË

Sa më shumë të kthehemi pas në kohë, muzika duket se ka ekzistuar gjithmonë, edhe para shpikjes së instrumenteve muzikore, pavarësisht nëse është bërë duke përdorur trokitjen e duarve, të copave të drurit ose të gurëve. Me idenë e ritmit, praktika muzikore u kodifikua sigurisht shumë shpejt, **sepse duhej të bënte perënditë, të fuqishmit dhe në fund popullin, të kërcenin**. Në veçanti, grekët ishin teoricienët e parë dhe të cilët i caktuan një rëndësi fillestare kësaj forme të artit; për shembull, më shumë rëndësi se poezisë ose kërcimit. Gjithçka që dihet rreth muzikës midis grekëve vjen nga **veprat teorike për muzikën**, veprat nga poetët dhe shkrimtarët, si dhe **paraqitjet në vazo**. Në fakt, mund të shikojmë rolin e rëndësishëm të muzikës midis grekëve nga **pjesët e tilla si "Himnet e Delfit"* për Apollonin dhe "Ode për Afërditën", të kompozuar nga Sapfoja (ose Safoja), poetja më e madhe greke e lashtësisë**.



(Fig. 8) Një poete lirike greke e lindur në **ishullin e Lesbos** në veri të Detit Egje. Poemat e saj janë pothuajse krejtësisht monodike* dhe poema e saj e vetme e plotë është ajo që i drejtohet Afërditës. **Shumica e poemave të saj i njohim falë papiruseve të zbuluara në shekullin e 19-të**, në fragmentet ku ajo flet vetëm për familjen dhe miqtë e saj.

(Fig. 8) *James Pradier, Sappho (Safo)*, Francë, 1848, allçi, L. 41,6 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

Një tjetër vepër që mund ta lidhim me muzikën është kjo figurinë e një vajze të re duke kërcyer (Fig. 9). E zbuluar në Athinë, jo shumë larg nga shpella që i kushtohej Panit* dhe nimfave, kjo figurinë në terrakotë të pikturuar paraqet një nimfë* (që lidhej me Panin) ose një menadë* (që lidhej me Dionisin* ose edhe me Afërditën). Gjallëria e pozës së saj (koka e anuar, manteli i ngjitur pas trupit, krahu i majtë i përkulur prapa) dëshmon dëshirën e artistit për të pasqyruar energjinë dhe lëvizjet e kërcimtares.

(Fig. 9) *Figurinë e një vajze të re duke kërcyer, e quajtur valltarja Titeux**, Greqi, 375–350 p.e.s., terrakotë me gjurmë boje, L. 21 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.



NGA E QESHURA NË TË QARË: SHPREHJA E EMOCIONEVE

Në cilëndo formë që të kenë mbijetuar poemat e lashta ose mesjetare (të plota ose me fragmente), **ato pasqyrojnë lëvizjen e shpirtrave dhe shprehjet, të lidhura ngushtë me fenë në botët e lashta.** Kjo është e vërtetë edhe për gëzimin, i cili si në botën egjiptiane, ashtu dhe në atë greke, ishte deri diku një përjetim kolektiv. **Në Egjiptin e lashtë, perëndia qiellore dhe edukuese e gëzimit dhe muzikës Hathori*** kryesonte për sa u përket ceremonive dhe festave të mbajtura për nder të saj.

Midis viteve 2200 dhe 1900 p.e.s., një dinasti lokale riktheu shkëlqimin e qytetit të **Biblosit, Xhibeil** të sotëm në Liban. Ishte atje, në faltoren e perëndeshës së madhe, vendi ku u gjetën maskat e vogla prej ari (Fig. 10) që paraqesin perëndeshën me një fytyrë njerëzore dhe me veshë lope.

(Fig. 10) *Maskë prej ari e perëndeshës Hathor*, Liban, 1200 p.e.s.–324 e.s., ar, L. 12,8 cm x Gj. 11,6 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.



A E DINI?

Temat qartësisht universale të humbjes dhe të dëshpërimit janë gjithashtu ndjenja që përshkojnë krijimtarinë poetike femërore të Pellgut të Mesdheut. Kjo mund të shikohet në koleksionet e Luvrit nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme të vajtueseve (Isisi* duke vajtuar Osirisin*), portreteve funerare që ruajnë kujtimin e të vdekurve dhe relieveve funerare me mbishkrimin "Fatkeqësisht!" nga zona e Palmirës në Siri.



Ky shembull i rrallë i një skulpture prej qeramike (Fig. 11) mund të jetë perëndesha Isis duke vajtuar vëllanë dhe bashkëshortin e saj Osiris, me duart në kokë në shenjë vajtimi* (krahu i palosur mbi kokë pasqyron vërtet gjestin tipik të vajtimit).

(Fig. 11) *Terrakotë e pikturuar e një vajtueseje*, Egjipt, 1550–1425 BCE, terrakotë, L. 24,3 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

Një shembull tjetër është relievi funerar (Fig. 12) që paraqet bustin e një gruaje, të veshur me tunikë dhe me mantel të mbajtur nga një fibulë* trapezoidale me një kokë luani mbi të, e cila e mban dorën e saj në faqe në shenjë vuajtjeje*. Kur palmirianët përkujtonin të vdekurit, përdornin këtë lloj stele individuale me një epitaf* të zbukuruar me emrin e të vdekurit, origjinën e tij ose të saj dhe shprehjen tipike: "Fatkeqësisht!".

(Fig. 12) *Ummayat, daughter of Yarhai (Umajati, vajza e Jarhait). Fatkeqësisht!*, Siri, 100–200 e.s., gur gëlqeror, L. 53 cm x Gj. 43 cm x Th. 21 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.



Të konsideruara si një prej pasqyrimeve më të bukura të skulpturës greke, këto figura të vogla shumëngjyrëshe* ishin objekte të çmuara të përdorura në tempuj dhe shtëpi si zbukurime ose si objekte funerare. Kjo figurinë paraqet një vajtuese profesioniste (Fig. 13), një person i pajtuar për t'u shtirur si e pikëlluar në një funeral.

(Fig. 13) *Figurina e Tanagras**, Greqia Qendrore, 600 p.e.s., baltë, L. 18,5 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

EKSPLORONI MË TEJ

Për të eksploruar më tej, mund të përdorni shembujt e mëposhtëm si pika fillestare (me mundësinë për të kërkuar referenca të tjera në klasë):

ANSAMBLI KÉRYLOS

Ansambli Kérylos u formua në vitin 1990 nga Annie Bélis. Ai luan muzikë greke pikërisht si do ta kishin dëgjuar vetë grekët e lashtë, duke rindërtuar instrumente besnike ndaj origjinalëve.

Lidhja: <https://www.kerylos.fr/>

- Mund ta vini klasën të dëgjojë një pjesë muzikore të luajtur nga Ansambli Kérylos.

AKTIVITETI I SUGJERUAR MËSIMOR (MOSHAT 9–15 VJEÇ):

Imagjinoni dhe kompozoni një himn epik për një perëndeshë që dëshironi, në stilin e poemave të Sapfos.

- Për kujtesë, një himn epik nderon një hero ose heroinë duke lavdëruar veprimet, cilësitë dhe arritjet e tyre, në mënyrë që t'u kërkohej një favor.

Pajisjet: Fletë në formatin A4, lapsa, stilolapsa

Fragment nga poema "Hymn to Venus" ("Himn për Afërditën"), nga Sapfoja:

"Fronstolisur, Afërditë e pavdekshme, bijë e Zeusit, kurthengritëse, të falem; me vaje të hidhura, mos, o Zonjë, shpirtin mos ma mundo. Por eja, siç dëgjove dikur lutjen time së largu dhe m'u përgjigje, le pallatin e atit dhe erdhe duke ngarë koçinë e artë, (...) Dhe ti the kështu, perëndeshë e nderuar? Eja, pra, dhe tani, shpëtomë nga mundimet dhe shqetësimet (...)"

3. GRATË NË EGJIPTIN E LASHTË, MIDIS NËNSHTRIMIT DHE LIRISË

*Statuja e Karomamas, Divine Adoratrice of Amon
(Adhuresja hyjnore e Amonit)*



Në lashtësi dhe gjatë periudhës faraonike (3100–30 p.e.s.) në veçanti, **gratë egjiptiane zinin një vend pothuajse të barabartë me burrat, të paktën para ligjit. Si rrjedhojë, ato mund të blinin dhe të shitnin pronën e tyre**, mund të diskutonin për zgjedhjen e bashkëshortit të tyre me babain e tyre, si dhe të divorcoheshin ose madje të ndiqnin studime të caktuara (shkrim, mjekësi, kirurgji).



ÇFARË ËSHTË BASHKË-SHORTJA MBRETËRORE?

Ndryshe nga njerëzit e zakonshëm, Faraoni mund të kishte disa bashkëshorte. Në veçanti, njëra nga bashkëshortet kishte një titull të veçantë, "bashkëshortja e lartë" ose "bashkëshortja mbretërore". E konsideruar si një këshilltare e mbretit, ajo ishte e vetmja që mbarte attribute të njëjta me faraonin dhe hyjnitë, përveçse kishte një rol jetik në edukimin e trashëgimtarëve të fronit.

(Fig. 14) *Copë nga një qefin i lyer, Egjipt, 1295–1069 p.e.s., pëlhurë liri, L. 25 cm x Gj. 21 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.*

A E DINI?

Në Egjiptin e lashtë, kishte gra të rangut të lartë, dhe madje një faraone, që ishte posti më i lartë. Gjithashtu, disa bashkëshorte mbretërore (të tilla si **Nefertari**, bashkëshortja e Faraonit **Rameses II** ose **Nefertiti**, bashkëshortja e Faraonit **Akhenaten**) kishin ndikim të konsiderueshëm te bashkëshortët e tyre në aspektin politik dhe diplomatik. Nga ana tjetër, si këmbim, ato duhet të ishin besnike, kurse burrat mund të kishin shumë bashkëshorte pa asnjë pasojë.

PREZANTIMI I VEPRËS NR. 3:

*Statuja e Karomamas, Divine Adoratrice of Amon
(Adhuresja hyjnore e Amonit)*

Në të gjithë Pellgun e Mesdheut, në Egjipt sikurse në Greqi, Liban dhe Itali, madje dhe në Tunizi, faltoret e mëdha mirëpritën priftëreshat, figurat femërore fetare dhe besimtarët, të cilët festuan dashurinë e tyre për hyjninë që adhuronin. Disa prej tyre, siç dëshmohet nga statuja prej bronz i **Karomamas** (Fig. 15), janë midis kryeveprave të Luvrit. E blerë në vitin 1827 nga burri që deshifroi hieroglifet për herë të parë, egjiptologu francez **Jean-François Champollion** (1790–1832), mbishkrimi në bazën e saj tregon identitetin e saj: "e dashura e Amon-Ra, ajo është bashkëshortja e tij hyjnore, Divine Adoratrice (Adhuresja Hyjnore)".

Kjo statujë e punuar bukur, na kujton rëndësinë e grave, të cilat në shekullin e 9-të p.e.s., **shërbyen për të forcuar lidhjet midis pushtetit mbretëror dhe klerikëve të Amonit***, kur Egjipti ishte i ndarë midis "priftërinjve-mbretër" (në jug) dhe faraonëve (në veri).



(Fig. 15) *Statuja e Karomamas, Divine Adoratrice of Amon (Adhuresja hyjnore e Amonit, Egjipt, 870 p.e.s., bronz, L. 64 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.*

A E DINI?

Ekzistonte një kohë në Egjipt kur Faraoni Smendes*, (me origjinë të paqartë), i qytetit të Tanisit* mori kontrollin e veriut të vendit, ndërsa jugu i vendit kontrollohej nga priftërinjtë e lartë të Amonit në Tebë*, të cilët e shpallën veten mbretër dhe grumbulluan sipërfaqe të mëdha toke në mënyrë që të rritnin fuqinë e tyre. Ishin këto rrethanat kur vajzat u dërguan në Tebë të bëheshin "Adhureset Hyjnore të Amonit", dhe si rrjedhojë bashkëshortet e perëndisë, duke i lejuar faraonët të mbanin nën kontroll priftërinjtë-mbretër të Tebës.



Ky fragment i një pllake shkrimi (Fig. 16) është **dëshmia e shkëmbimeve diplomatike midis oborreve mbretërore egjiptiane dhe hitite**. Pllaka e shkrimit **evokon martesën mbretërore midis vajzës së mbretit hitit* Hatusili III (1267–1237 p.e.s.) dhe Faraonit Rameses II (1301–1236 p.e.s.)**. Kjo aleancë martesore* erdhi 13 vite pas traktatit të paqes të nënshkruar pas Betejës së **Kadeshit*** e cila, rreth vitit 1274 p.e.s., i kishte dhënë fund disa viteve konflikt midis mbretërisë hitite dhe Egjiptit. I shkruar në gjuhë akadiane, **ky fragment na lejon të shqyrtojmë statusin e grave (sidomos të grave të huaja) në oborrin mbretëror të Egjiptit, nëpërmjet "martesave midis dinastive"**.

(Fig. 16) *Fragment i një pllake shkrimi të një letre nga Ramesesi II për Hatusilin III ku evokohet martesa e një vajze të mbretit hitit* me Faraonin, Turqi, 1450–1190 p.e.s., terrakotë, L. 5,7 cm x Gj. 5,5 cm x Th. 2,4 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.*

ADHURUESET HYJNORE, GARANTUESET E PUSHTETIT TË FARAONIT

Titulli i "adhurueses" i referohet **priftëreshave të caktuara që kanë lidhje me perëndeshën Hathor** (perëndesha egjiptiane e barasvlershme me Afërditën, perëndeshën e dashurisë) **ose me perëndinë Amon**, rreth të cilave ishte formuar një kult i vërtetë në Tebë (Egjipti jugor). **Në mënyrë që të zgjonin dëshirën midis perëndive krijuese ose për të kryer rite të caktuara, shumë gjenerata të vajzave egjiptiane u zgjodhën të bëheshin bashkëshorte të Amonit**. Roli i tyre ishte parësor brenda klerit teban të Amonit sepse ishin përfaqësuese të sovranëve në kryeqytetin fetar egjiptian. Me një status të krahasueshëm me atë të një hyjnie, **ato duhet të mbeteshin beqare gjithë jetën e tyre, të martuara me perëndinë e vetme supreme, të rrethuara nga këngëtare virgjëresha dhe të merrnin pjesë në ritet në faltore**.

Kjo skulpturë (Fig. 17) nënvijëzon **rolin qendror që kishin gratë në besimin fetar në Egjiptin e lashtë** rreth adhurimit të Amonit gjatë kësaj periudhe. I mbajtur nga gra egjiptiane të klasave krejtësisht të ndryshme, titulli i "adhurueses" përcaktonte në mënyrë efektive priftëreshat e përkushtuara në shërbim të Amonit, **gra të pushtetshme me role të rëndësishme fetare dhe politike**.

(Fig. 17) *Henoutideh, singer for Amon (Henoutideh, këngëtarja e Amonit)*, Egjipt, 1425–1400 p.e.s., gur ranor, L. 102 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.



POZICIONI I GRAVE NË ÇIFTET E PASURA




Brenda shtëpisë, roli i gruas ishte, mbi të gjitha, ai i zonjës së shtëpisë: ajo menaxhonte drejtimin e shtëpisë, shërbëtorët dhe duhej të ishte edhe një konkubinë* e përkryer, ndonëse bashkëshorti i saj mund të ishte poligamik.

(Fig. 18) Burri paraqitet **duke lëvizur**, që tradicionalisht do të thotë se është ai që punon. Ne mund ta krahasojmë këtë me statujën e Karomamas, e cila **edhe ajo e portretizon atë duke lëvizur megjithëse është grua, që është një shenjë e rëndësisë së saj.**

(Fig. 18) *Statujë e një çifti*, Egjipt, 2500–2365 p.e.s., gur gëlqeror, L. 52,8 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

Sikurse shumica e paraqitjeve të çifteve që shfaqin dashurinë e tyre, ky reliev i gdhendur (Fig. 19) paraqet jetën familjare dhe barazinë në çiftin mbretëror.

(Fig. 19) *Akhenateni, Nefertiti dhe fëmijët e tyre*, Egjipt, 1350–1330 p.e.s., gur gëlqeror, L. 24,7 cm x Gj. 34 cm x Th. 5,5 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais



EKSPLORONI MË TEJ

Për të eksploruar më tej, mund të përdorni shembujt e mëposhtëm si pika fillestare (me mundësinë për të kërkuar referenca të tjera në klasë):

HATSHEPSUTI

Hatshepsuti (1508–1458 p.e.s.), **faraonia e vetme egjiptiane**, e paraqitur shpesh me të gjitha atributet e faraonit, duke filluar me perizomën dhe postiqen (mjekrën e rreme).

- Mund t'i tregoni klasës një prej statujave të Luvrit të Hatshepsutit (numri i inventarit: E 11057) dhe ta përshkruani me nxënësit.

NAWAL EL SAADAWI

Nawal El Saadawi (1931-2021), një shkrimtare egjiptiane, që pasqyron **evolucionin e trajtimit të grave në shoqërinë egjiptiane dhe një pioniere e emancipimit të grave në botën arabe**.

- Mund të bëni një lidhje me "Memoirs of a Woman Doctor" ("Kujtimet e një mjekeje"), romani i saj gjysmëautobiografik. Në të, një grua e re egjiptiane e viteve 1950 përballet me mungesën e mirëkuptimit të familjes së saj kur ajo shpall se dëshiron të bëhet mjeke, në vend që t'i nënshtrohet një martese me mblesëri dhe mëmësisë. Kështu fillon puna e saj e vështirë për të përmbushur ëndrrat e saj.

FAIROUZ

Fairouz (lindur në vitin 1934), **një këngëtare libaneze, divë e botës arabe** me pseudonimin "shpirti arab" dhe "ambasadorja libaneze në yje". Me prejardhje nga një familje e thjeshtë e krishterë në Bejrut, Fairuz u bë e njohur për zërin e saj unik, karizmën e saj dhe këngët e saj të shkurtra dhe nostalgjike, në të cilat ajo këndon për luftën, mërgimin dhe ëndrrën e unitetit.

- Mund të dëgjoni të gjithë si klasë këngën "Bhebbak ya Lebanon" ("Të dua o Libani im"), të interpretuar nga Fairuz në vitin 1973.

4. QYTETËRIMI ETRUSK: NJË PORTË KULTURORE

Sarkofagu i bashkëshortëve



I konsideruar si **qytetërimi i parë i madh italic pararomak**, qytetërimi etrusk filloi në fund të **shekullit të 12-të p.e.s. dhe zgjati deri në shekullin e 1-rë p.e.s.** Të shtrirë nga lugina e lumit Po deri në Gjirin e Salernos në jug, **etruskët shfrytëzuan hapjen e tregjeve, aleancat luftarake dhe praninë e tyre detare për të krijuar lidhje me qytetërimet e tjera të Mesdheut**, duke përfshirë grekët dhe fenikasit, duke lartësuar veprat artistike, artizanale dhe fetare në kryqëzimet e kulturave.

PAK GJEOGRAFI?

Italic: term që emërton popujt që kanë banuar në gadishullin italian, të njohur që në mijëvjeçarin e 1-rë p.e.s. dhe të cilët u asimiluan nga Roma nga shekulli i 3-të p.e.s.

Lugina e lumit Po: luginë e madhe në Italinë e Veriut, duke përfshirë qytete të mëdha, të tilla si Torino, Milano dhe Pavia.

Gjiri i Salernos: pjesë e detit në bregun jugperëndimor të Italisë.

Fenikia: qytetërim i lashtë i përbërë nga qytet-shtete të pavarura që dikur shtriheshin aty ku sot është Siria, Libani dhe Izraeli i Veriut.

Apulia: emër i lashtë i rajonit të Pulias në Italinë Jugore.



Harta e Italisë: shtrirja e etruskëve.
©TheNationalGeographic.

PREZANTIMI I VEPRËS NR. 4:

Sarkofagu i bashkëshortëve



Ishte viti 1845 kur **Giampietro Campana**, një koleksionist i madh antikash dhe veprash arti, zbuloi këtë sarkofag (Fig. 20) në nekropolin* etrusk të Çerveterit (në veriperëndim të Romës). Si provë e mjeshtërisë së pjekjes së argjilës të mësuar nga etruskët, ky sarkofag paraqet një çift të vdekur, që janë përqaftuar me dashuri së bashku dhe që po marrin pjesë në një gosti ku hahej në pozicionin shtrirë.

(Fig. 20) *Sarcophagus of the Spouses* (Sarkofagu i bashkëshortëve), Itali, 520–510 p.e.s., baltë e kuqe, L. 114 cm (me kapak) x Gj. 194 cm x Th. 74 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

NJË GOSTI KU HAHET NË POZICIONIN SHTRIRË?

Kjo praktikë aristokrate, me prejardhje nga Greqia dhe Lindja e Afërt në shekullin e 7-të p.e.s., para se të merrej nga romakët, kishte një ndryshim të dukshëm midis etruskëve: ndryshe nga gratë greke, gratë etruske merrnin pjesë në gosti përkrah bashkëshortëve të tyre. Duke qenë me rëndësi të madhe shoqërore, **gostitë ishin vendi për aleancat, marrëdhëniet midis familjes dhe festimin e momenteve të rëndësishme (festivale, ditëlindje, martesë, funerale etj.).**

A E DINI?

Giampietro Campana (1809-1880) ishte një borgjez i madh nga Roma në gjysmën e parë të shekullit të 19-të. Ai ishte një bankier i papatit, një mbledhës i pasionuar i artit italian, por njihej edhe si hajdut dhe falsifikues.



(Fig. 21) *Krater, rrëmbimi i Evropës*, Apulia, rreth 360 p.e.s., baltë, L. 48 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

Krateri i pikturuar këtu (Fig. 22) është me origjinë greke, që thekson dialogun midis kulturave greke dhe etruske, ku në këtë rast procesi quhet transferim i teknologjisë*.


(Fig. 22) *Krater*, Apulia, rreth 460 p.e.s., baltë, L. 37 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.



NJË ROL MË I MADH PËR GRATË ETRUSKE

Gratë etruske kishin shumë më tepër liri veprimi sesa homologet e tyre greke dhe romake.

Megjithëse ato qëndronin të nënshtruara* ndaj bashkëshortëve të tyre dhe nuk sunduan asnjëherë në botën etruske, ato mund të bënin gjëra të tilla si të dilnin, të merrnin pjesë në gosti (një praktikë e rezervuar atëherë për aristokratët), të ndiqnin lirshëm lojërat, të merrnin pjesë në jetën politike, të kishin funksione priftërore dhe të pinin verë. Gjithashtu, gratë etruske konsideroheshin si individë të lirë me të drejtat e tyre, duke gëzuar kështu një status ligjor më të mirë se gratë në pjesën tjetër të Mesdheut. **Në mungesë të burimeve letrare etruske, janë kryesisht materialet arkeologjike* të gjetura gjatë gërmimeve në varret etruske dhe në nekropole që dëshmojnë prestigjin e veçantë social të grave.**



Këtu është e pikturuar një **urnë hiri*** (Fig. 23), **shumë e zakonshme në veprat funerare greke dhe etruske**. E përdorur për të mbajtur hirin e të vdekurit, e zbukuruar me një reliev në anën balllore dhe një portret të të vdekurit në kapak **Larthi Ceicnei Prethrei**, një grua 25 vjeçare, **në një pozicion trupi që tradicionalisht ishte deri diku mashkullor (burri në gosti) dhe duke mbajtur një libër, që do të thotë se ajo kishte njëfarë arsimimi.**

(Fig. 23) *Master of Myrtilus (Mjeshtri i Mirtilos)*, kapak urne, Itali, alabastër, 175–150 p.e.s., L. 48 cm x Gj. 79 cm x Th. 33 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

TRASHËGIMIA ETRUSKE NË KULTURËN ROMAKE

Me karakteristikat e një mënyre jetese **të mbushur me përsosuri dhe ekspertizë**, siç dëshmohet nga mjeshtëritë, njohuritë për metalet dhe gurët e çmuar, arkitektura dhe trashëgimia, kultura etruske la një trashëgimi të jashtëzakonshme kulturore që la gjurmët e saj në Romën e lashtë. **Etruskët u asimiluan gradualisht nga Perandoria Romake, midis shekullit të 4-t dhe të 1-rë p.e.s.** Ato njiheshin si lundruer të aftë dhe mjeshtër të përsosur, të cilët ruajtën kulturën e tyre, ndërkohë që përfshinë veprat, kultet dhe përdorimet nga pjesa tjetër e Mesdheut. **Trashëgimia e tyre e jashtëzakonshme u ruajt në të vërtetë nga romakët:** përveç attributeve të tyre që u bënë simbole të autoritetit romak (karrigia kurule, sëpatat e liktorëve, toga, bula), romakët adhuruan gjithashtu të njëjtat hyjni me etruskët, thjesht ndryshuan emrat e tyre ose disa prej attributeve të tyre.

SIMBOLET E AUTORITETIT ROMAKE

Karrigia kurule: nga tradita etruske, kjo karrige u bë një prej simboleve kryesore të pushtetit në Romë, e rezervuar fillimisht për gjykatësit, para se të bëhej një prej attributeve të perandorit të quajtur August (63 p.e.s.–14 e.s.). **Sëpatat e liktorëve:** në antikitet, një sëpatë e rrethuar nga një tufë shufrash druri, që ishte një objekt simbolik dhe mjet ndëshkimi i mbajtur nga liktorët (zyrtarët publikë) përpara disa gjyqtarëve romakë. **Toga:** një copë e madhe pëlhure prej leshi pa qepje, e veshur mbi rroba nga qytetarët romakë në lashtësi. **Bula:** varëse e rrumbullakët prej ari (për të pasurit) ose lëkure (për të varfrit) që mbahej veshur në Romën e lashtë si një nuskë mbrojtëse.

DISA SHEMBUJ:



Venusi* është një hyjni romake që ka karakteristika të përbashkëta me **Turanin***, hyjninë etruske të barasvlershme me të (perëndesha e dashurisë, bukurisë, pjellorisë dhe shëndetit), **e cila dëshmon për afërsinë midis këtyre kulturave.**

(Fig. 24) *Venus de Milo (Afërdita e Milos)*, Greqi, shekulli i 2-të p.e.s., mermer, L. 204 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

Bashkëshortja e perandorit **August** (63 p.e.s.–14 e.s.), **Livia** (58/59 p.e.s.–29 e.s.) përshkruhet këtu si **Cereza** (Fig. 25), e cila ishte perëndesha romake e bujqësisë, të korrave dhe pjellorisë (homologia e perëndeshës greke **Demetra**). Perandori August përdori **sterilitetin e bashkimit të tyre si një mjet propagandistik për të lartësuar modelin e matronës romake*** (e dliirë, virtuoze, e kufizuar në sferën shtëpiake). **Perandoresha e parë që u hyjnizua* pas vdekjes së saj,** thuhet se ka qenë një bashkëshorte e mirë, pas 52 vitesh martesë.



(Fig. 25) *Statuja e Livias si Cereza*, Itali, 25–50 e.s., mermer, L. 199 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.



Një perandoreshë romake me origjinë siriane, **Julia Domna** (160–217 e.s.) tregohet këtu e skalitur që të duket si priftëreshë e Isisit* (Fig. 26), një perëndeshë egjiptiane, kulti i së cilës u zhvillua në Romë gjatë shekullit të 1-rë e.s. **Kjo skulpturë jep një këndvështrim të kundërt me atë të uljes së rolit të grave në sferën shtëpiake dhe humbjes së fuqisë politike të tyre.** Në të vërtetë, Julia Domna u bë një **perandoreshë me një rol të rëndësishëm, përveçse konsiderohej një perëndeshë.**

(Fig. 26) *Julia Domna*, Greqi, 193–209 e.s., mermer, L. 202 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais

EKSPLORONI MË TEJ

Për të eksploruar më tej, mund të përdorni shembujt e mëposhtëm si pika fillestare (me mundësinë për të kërkuar referenca të tjera në klasë):

CHRISTINE DE PIZAN

Christine de Pizan (1364/1365–1430) ishte një poete mesjetare që mendohet se është **autorja e parë që ka fituar me sukses të ardhura nga shkrimet e saj**. Ajo shkroi tekste që lartësonin virtytet e Tanakuilës (një grua fisnike etruske që jetoi në shekullin e 6-të p.e.s.).

- Mund të lexoni një fragment nga kapitulli 45 i veprës "La Cité des dames", ("Qyteti i grave") të Christine de Pizan, në të cilën ajo e përmend **Tanakuilën** (e quajtur gjithashtu **Gaia Caecilia**) si një grua të lavdërueshme, e cila dallohej shumë, si dhe ishte virtuoze, besnike dhe e mirë, duke e bërë atë një shembull për t'u ndjekur nga gratë romake.

BAYA

Baya (1931-1998), ishte një piktoe algjeriane që studioi në Muzeun e Arteve të Bukura në Algjer. Subjektet e saj të preferuara **ishin gratë dhe paraqitjet e tyre** (me flutura, objekte të përditshme, instrumente muzikore, mobilie, fruta etj.).

- Mund t'i tregoni klasës një prej pikturave të Baya (për shembull, "Conte 1: La dame dans sa belle maison" [Përralla 1: Zonja në shtëpinë e saj të bukur], 1947, bojëra uji opake në letër, 24 x 31 cm, Aix-en-Provence) dhe kërkon nga klasa të përshkruajnë ngjyrat dhe emocionet që u shkakton ajo.



5. ORIGJINAT E SKULPTURAVE GREKE

Kore, Zonja e Okserit

Megjithëse shumë pak vepra greke kanë mbijetuar, ka mjaftueshëm vepra origjinale, fragmente dhe kopje për të na dhënë një ide të cilësisë dhe sasisë së tyre.

A E DINI?

Para vitit 650 p.e.s., nuk bëheshin skulptura prej guri me përmasa reale, dhe ishte në atë kohë kur Faraoni **Psamtik I** (664–610 p.e.s.) lejoji dy grupe grekësh të vendoseshin përgjatë Nilit. Kjo ishte mënyra se si **emësuan grekët artin e skulpturave prej guri në shkallë të madhe nga egjiptianët,** me përjashtim të faktit që ato përdornin gurin gëlqeror dhe mermerin (që gjendej më lehtë në Greqi), më shumë sesa porfirin dhe granodioritin që preferoheshin nga egjiptianët.

ARTI GREK

Periudha më e hershme greke që i kushtohej artit të skulpturës ishte periudha arkaike*. Kjo ishte koha kur lulëzoi stili **dedalian**, i cili u emërtua sipas arkitektit Dedalus, i cili besohej nga grekët se ishte shpikësi i labirintit në të cilin u burgos **Minotauri***. Karakteristikat e veprave nga kjo periudhë **përfshinin fytyrën e zgjatur dhe trekëndore, sytë si bajame dhe stilin egjiptian të flokëve** (paruke trekëndore), siç shikohet në "kouros" ose "couros" (statuja e një burri lakuriq me flokë të gjata dhe muskuj shumë të zhvilluar) dhe **homologen e tij "kore" ose "core"** (statuja e një gruaje të veshur, që qëndron me këmbët e bashkuara dhe duke paraqitur një objekt për një hyjni).

GURËT E NDRYSHËM

Porfiri: gur vullkanik (gur që formohet kur magma nga një vullkan ftohet dhe forcohet) që është shumë i fortë, përmban tufa të kristaleve të feldspatit dhe është në ngjyrë vjollcë, i kuq, jeshil ose ngjyrë kafe. Ai konsiderohej dikur simboli i jetëgjatësisë midis egjiptianëve. **Granodioriti:** gur vullkanik që përmban kristale, me një përbërje midis granitit dhe dioritit dhe i cili ka ngjyrë gri dhe rozë. **Guri gëlqeror:** një gur sedimentar që është i butë dhe i lehtë për t'u skalitur. Skulptorët në antikitetin egjiptian dhe grek e përdorën gjerësisht atë.

PREZANTIMI I VEPRËS NR. 5:

Kore, Zonja e Okserit



Një statujë greke me gur gëlqeror që daton nga shekulli i 7-të p.e.s., "Lady of Auxerre" (Zonja e Okserit) (Fig. 27) **është një kryevepër e artit grek në stilin dedalian.** Ajo paraqet një grua të veshur me një fustan të gjatë pas trupit* që ngushtohet në bel me një rrip të gjerë dhe krehja e flokëve të saj të sjell ndër mend stilin egjiptian. **Statuja ka një pamje "të papërpunuar", me përjashtim të disa gjurmëve të bojës së kuqe në trup.** Megjithatë, ne e dimë se ajo ishte dikur e lyer sepse mund të dallojmë ende vijat parapërgatitore të skalitura të zbukurimit shumëngjyrësh që është zhdukur që atëherë. Stili i saj e vendos atë në qendër të shkëmbimeve artistike midis Egjiptit nga njëra anë dhe artit **kikladik*** në anën tjetër, i cili është veçanërisht i dukshëm në **frontalitetin dhe stilin mbresëlënës të flokëve**, të cilët janë ndikim egjiptian.

(Fig. 27) Kore, *The Lady of Auxerre (Zonja e Okserit)*, Greqi, 630 p.e.s., gur gëlqeror, L. 75 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

MITET DHE FIGURAT FEMËRORE

Historia e zbulimit të statuetave kikladike* daton në fillim të shekullit të 19-të. Shumica e tyre ishte prej mermeri, paraqitnin kokat dhe trupat e grave lakuriq, nuk ishin shumë të gjera dhe tregonin vetëm hundën në reliev. **Mendohet se këto statueta që paraqesin figura femërore me forma të pasura* dhe të stereotipizuara*, të cilat datojnë nga fillimi i Epokës së Bronzit (3200–2400 p.e.s.) dhe të krijuara në arkipelagun grek të Kikladeve, ishin elemente kryesore të jetës fetare* të kohës, që ndoshta shërbenin për të shoqëruar të vdekurin, për t'i ndihmuar që të merrnin pjesë në ritet e kalimit ose për të mbrojtur në mënyrë simbolike shtëpinë. Në mungesë të një termi më të përshtatshëm, ato janë përshkruar si idhuj, edhe nëse funksioni i tyre nuk është konfirmuar ende.**



E konsideruar si **Mona Lisa e artit kikladik** (Fig. 28), kjo kokë idhulli është një nga kryeveprat e Luvrit dhe ndikimi i saj u përhap tek **artistët avangardë të shekullit të 20-të, të tillë si Picasso, Modigliani dhe Brancusi**. Madhështore për nga madhësia, mbresëlënëse për nga pastërtia*, e lëmuar dhe padyshim e lyer me ngjyrën e kohës (grimi, tatuazhet etj.), **kjo kokë idhulli të sjell ndër mend origjinën e skulpturave greke dhe gjithashtu adhurimin e idhujve femërorë të pjellorisë.**

(Fig. 28) Kokë nga Keros*, Greqi, 2630–2400 p.e.s., mermer, L. 27 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

Stelat e Tanit, në anën tjetër, janë dokumentuar më mirë. Departamenti i Antikiteteve të Lindjes së Afërt në Luvër strehon më shumë se 1420 prej tyre, të cilat vijnë nga **Kartagjena** (në Tunizi) dhe dëshmojnë për qytetërimin punik* që u zhvillua atje gjatë Epokës së Hekurit (midis vitit 800 p.e.s. dhe fundit të shekullit të 1-rë e.s.). **Të dokumentuara gjerësisht në Tunizi dhe më tej, në disa qendra të rajonit siro-palestinez, kjo lloj krijimtarie i kushtohej Tanit, perëndeshës punike dhe numidiane* të pjellorisë, e cila simbolizohej nga një trekëndësh me një vijë horizontale në krye mbi të cilën ishte vendosur një rreth.**



Kjo stelë punike (Fig. 29) është e zbukuruar me **me motive të skalitura ose të gdhendura dhe me një mbishkrim** duke përfshirë një kushtues*, **prejardhjen e personit dhe hyjnitë mbrojtëse* të Kartagjenës: perëndeshën Tanit (përgjegjëse për të siguruar pjellorinë, lindjen dhe rritjen dhe për paraqitjen e bukurisë femërore) dhe perëndinë Bal Hamon***. E paraqitur me forma gjeometrike (trekëndëshi dhe rrethi), ajo mban një stap lajmëtari* në dorën e majtë duke vështuar një delfin që noton. **Është një prej relikteve të një kulti që ngre ende sot pikëpyetje.**

(Fig. 29) *Stele of Tanit (Stela e Tanit)*, Tunizi, 200–0 p.e.s., gur gëlqeror, L. 56 cm x Gj. 19,5 cm x Th. 7,5 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN - Grand Palais.

NGJYRA NË ARTIN E LASHTË: ZBUKURIMI I STATUJAVE DHE INDIVIDËVE

Ashtu si egjiptianët, edhe grekët i zbukuronin pjesërisht ose plotësisht veprat e tyre. Si rrjedhojë, ishte e zakonshme që figurat e skalitura, veçanërisht ato femërore, **të përmirësoheshin me metal** (për flokët dhe qerpikët), **inkrustime* prej qelqi, fildishi dhe gurësh me ngjyra** (për sytë) **dhe bojë** (hollësitë e fytyrës, veshjet). Statujat femërore plotësoheshin gjithashtu me stoli (vëthë, kurora, gjerdanë, shirita krahu), ndërsa atletët dhe luftëtarët ishin të **pajisur me objekte** (kurora, shtiza, mburoja, shpata).

Statujat e **Sepës** dhe të gruas së tij **Nesës** (Fig. 30) janë midis statujave më të famshme egjiptiane që paraqesin njerëz të shquar në përmasa reale (mbi 1,69 m lartësi), **në një kohë kur vetëm faraonët e gëzonin këtë privilegj**. Në një pozicion statik, me një fustan që i derdhet në trup, i cili thekson zonën pubike* (dhe si rrjedhojë aspektin e pjellorisë dhe mëmësisë), **kjo statujë paraqet një imazh të idealizuar dhe të përjetshëm të rinisë**. Gjurmët e bojës jeshile tregojnë praninë e grimit të bazuar në pluhurin e malakitit* të bluar (pluhur antimoni).

(Fig. 30) *Statue of Nesa (Statujë e Nesës)*, Egjipt, 2700–2620 p.e.s., gur gëlqeror, L. 154,5 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN - Grand Palais



Kjo statujë paraqet **Polihmninë** (Fig. 31), një muzë greke e elokuencës dhe retorikës*. Pavarësisht nga ripikturimi* i saj modern në toron* dhe në kolonë, **kjo statujë balte tregon shumë gjurmë të bojës origjinale (e kuqe për flokët, buzët dhe kapakët e syve, rozë në pëlthurë dhe në sy, bluja egjiptiane e mëparshme në pëlthurë), gjë e cila ngre temën e polikromisë në skulpturat e lashta**.

(Fig. 31) *Muza, Azi e Vogël*, 100 p.e.s., baltë, L. 30 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

Ngjyra në artin e lashtë të statujave ngre pyetjen e grimit në jetën e përditshme, **megjenëse skulpturat ishin zgjatime të besimeve dhe praktikave të kohës.**

Kjo kupë (Fig. 32) me një bazë të zbrazët ka mbi të një bark në formën e trungut të konit* në të cilin paraqitet një fytyrë femre në relief. Një **verniki i zi*** është përdorur për sytë, kapakët e syve të bashkuar në mes dhe tre tufa floku të stiluara në formën e "kaçurrelit" në ballë dhe në faqe.

(Fig. 32) Kupë me fytyrë femërore, Siri, 1200–1150 p.e.s., enë prej argjile, L. 16,2 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.



A E DINI?

Në Mesopotami, grimi përdorej si nga burrat, ashtu dhe nga gratë, megjithëse më shumë përdorej nga gratë. Paraqitjet figurative, sidomos kur janë ruajtur gjurmët e polikromisë së tyre, **dëshmojnë përdorimin e rregullt të grimit, veçanërisht brenda oborreve mbretërore.**



Kjo pasqyrë përbëhet nga një disk, **njëra nga anët e të cilit është pasqyruese, ndërsa tjetra ka zbukurim mitologjik**, i rrethuar nga disa vija të holla bashkëqendrore* të skalitura. Këtu **Leda** tregohet e ulur mbi një gur, me një mjellmë me krahë të hapur para saj, me këmbën e vendosur mbi gjunjtë e saj. Kjo ikonografi i referohet mitit në të cilin perëndia **Jupiter** shndërrohet në një mjellmë për të joshur vajzën e vdekshme të re dhe të bukur. **Ky aludim për bukurinë femërore përshtatet mirë me këtë mjet kujdesi vetjak veçanërisht luksoz, që është i zakonshëm në Kampanjë* në fillimet e perandorisë.**

(Fig. 33) Pasqyrë që paraqet Ledën dhe mjellmën, Itali, 25 p.e.s.–50 e.s., argjend, L. 28,8 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais

EKSPLORONI MË TEJ

Për të eksploruar më tej, mund të përdorni shembujt e mëposhtëm si pika fillestare (me mundësinë për të kërkuar referenca të tjera në klasë):

AMEDEO MODIGLIANI

Amedeo Modigliani (1884-1920), **një artist italian i shekullit të 20-të** arti i të cilit është përshkruar shpesh si i ndikuar nga arti kikladik që ishte rizbuluar në fillim të shekullit të 20-të (i cili mund të shikohet përmes përdorimit prej tij të formave të stilizuara, të thjeshtuara, kokat në formë veze etj.).

- Mund të tregoni pikturën e një gruaje të pikturuar nga Modigliani (të tillë si "Jeanne Hebuterne in a large hat" ("Jeanne Hebuterne me kapelë të madhe"), 1918, vaj në kanavacë, koleksion privat) dhe ta krahasoni me idhujt kikladikë nga Luvri.

ZHANG YUNYAO

Zhang Yunyao (lindur në vitin 1985), **është një artist bashkëkohor kinez** i cili krijoi një interpretim të kokës së njohur nga Keros.

- Mund të tregoni një pjesë nga Yunyao të frymëzuar nga Kikladet (të tillë si "Study in Two Heads (Inceptions)" ("Studim në dy koka [Fillimet]"), 2021, laps, laps me ngjyrë, pastel në shajak, (227 cm x 175 cm) dhe ta përshkruani veprën me klasën.

AKTIVITETI I SUGJERUAR MËSIMOR (MOSHAT 6–15 VJEÇ):

Shkarkoni një vizatim bardhezi të Lady of Auxerre (Zonja e Okserit), printojeni dhe kërkojuni studentëve të imagjinojnë zbulimet e fustanit dhe ngjyrat e flokëve dhe të grimit etj. Më pas, në fund të aktivitetit, tregojini klasës restaurimin nga Universiteti i Kembrixhit (i disponueshëm duke klikuar këtu).

Pajisjet: printer, fletë e formatit A4, stilolapsa me majë shajaku, lapsa me ngjyra

6. PELLGU I MESDHEUT, TOKA E PUSHTIMEVE, ALEANCAVE DHE SHKËMBIMEVE

Portreti i Fajumit



Harta e Perandorisë Romake nga fundi i shekullit të 1-rë p.e.s.

©Secrétariat Général pour l'administration du Ministère des armées (Sekretariati i Përgjithshëm për Administratën e Ministrisë Franceze të Forcave të Armatosura).

Pas pushtimit të Italisë rreth **shekullit të 3-të p.e.s.** në momentin e fitores së saj në Luftën e 2-të Punike, **Roma u udhëhoq të ndërhynte gjithmonë e më shumë në Pellgun e Mesdheut, derisa siguroi kontrollin e plotë në fund të shekullit të 1-rë p.e.s.** Duke themeluar koloni* të ndryshme, nga Sicilia në Spanjë dhe nga Afrika e Veriut në Angli, Perandoria Romake shënoi praninë e saj në katër cepat e kontinentit dhe përjetoi epokën e saj të artë nën mbretërimin e **Perandorit Trajan** (98–117 e.s.).


Në atë kohë, kjo perandori e pafund përfshinte vende dhe popuj shumë të largët, **të cilët u bashkuan gradualisht rreth të njëjtës kulturë romake.** Ky "romanizim*" i popullatave lokale, bëri që ato të përvetësojnë të njëjtat mënyra jetese, gjuhën, kulturën, arkitekturën (tempuj, forume, banja publike, arena etj.), besimin fetar e kështu me radhë.

A E DINI?

Në perandori, gratë kishin liri të caktuara, megjithëse ato nuk ishin të barabarta me burrat. Ato i përkisnin klasës shoqërore të burrave të tyre, trajtoheshin si të parëndësishme dhe ishin nën kujdestarinë e babait të tyre ose të bashkëshortit të tyre. **Megjithatë, duhet theksuar që gratë e martuara ishin më të respektuara sesa të tjerat, sepse konsideroheshin si kujdestaret e shtëpisë.**

PREZANTIMI I VEPRËS NR. 6:

Portreti i Fajumit



Portretet e Fajumit u emërtuan sipas Fajumit, ku u zbuluan, e cili ishte një provincë e pasur bujqësore dhe ushtarake e lashtë gjatë pushtimit romak të Egjiptit. Ky portret i pikturuar në dru (Fig. 34) dhe i prodhuar gjatë jetës së modeles, mundësoi zëvendësimin e maskës funerare tradicionale egjiptiane me një portret të personit të vdekur të vendosur mbi mumien e tij ose të saj. Si pjesë e një sërë veprash të ruajtura shumë mirë nga klima e thatë e Egjiptit, **ai është një prej portreteve më të vjetër të pikturuar nga antikiteti.**

(Fig. 34) *Portret i Fajumit*, Egjipt, 117–138 e.s., gëlqere dru, L. 33 cm x Gj. 20 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

Me paraqitjen e anëtarëve të klasave të mesme dhe të larta të shoqërisë egjiptiane, ky lloj portreti tregonte individë të kulturës greke dhe egjiptiane, **por të veshur dhe të krehur sipas stilit romak** (me flokët me shteg në mes dhe veshët të zbuluar). Kështu, duke përzier traditën e riteve të funeraleve egjiptiane (mumiet) me trashëgiminë e pikturës greke (natyralizmin*) dhe me stilin romak, **ky portret ilustron kryqëzimin* e kulturave në Egjiptin e epokës pasaleksandriane.**

PËRPLASJET QË NXISIN TAKIMET

Midis shumë qyteteve mesdhetare që u asimiluan gradualisht nga Perandoria Romake, mund të shqyrtojmë për shembull, rastin e **Palmirës**. E ndodhur në veriperëndim të shkretëtirës siriane, **oazi* i Palmirës e arriti kulmin e tij në periudhat greko-romake**. Si një ish-qendër nevralgjike* e perandorisë së madhe, Palmira u integrua në Perandorinë Romake rreth shekullit të 19-të p.e.s., si pjesë e provincës romake të Sirisë. Kjo shpjegon pse ajo mori **elemente tipike të Romës: tregjet, kolonadat*, tempujt, teatrot dhe banjat publike**. Kështu që ndikimet romake ishin të pamohueshme, si në jetën e përditshme, ashtu dhe në praktikat kulturore dhe fetare, siç dëshmohet nga shumë portrete funerare palmirane.



Portreti nga Palmira (Fig. 35) demonstroi shtrirjen e Perandorisë Romake dhe numrin e kulturave mbi të cilat u ushtrua pushteti i saj. **Në të vërtetë, tipi i portretit si bust i prerë në bel është diçka e huaj për artin e Lindjes së Afërt** (përkundrazi, ai gjendet në artin romak), ndërkohë që subjekti paraqitet në stilin palmiran, pasi ka një karakteristikë të saktë të frontalitetit* të asaj kulture.

(Fig. 35) *Portret nga Palmira*, Siri, 200–300 e.s., gur gëlqeror, L. 52 cm x Gj. 58 cm x Th. 21 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais


Kjo lugë grimi (Fig. 36) tregon që praktikat e higjienës dhe të bukurisë ishin të njëjta në Pellgun e Mesdheut.

(Fig. 36) *Lugë grimi*, rajoni i Mesdheut, 1550–1425 p.e.s., dru, L. 22 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN Grand Palais.



MESDHEU NËN SUNDIMIN ROMAK

Si pjesë e dominimit të saj perandorak në Mesdhe, i cili zgjati deri në shekullin e 3-të e.s., **Roma solli bashkimin e rajoneve rreth parimit të "romanizimit"**; me fjalë të tjera, **banorët e Perandorisë Romake mund të shijonin përfitimet e autoritetit romak (dhe mbi të gjitha paqe) nëse elitat respektonin kulturën romake**. Pushtimi romak përshpejtoi gjithashtu shkëmbimet kulturore dhe gjuhësore nëpër pjesën më të madhe të Mesdheut, sidomos në anën perëndimore, para se rënia e Perandorisë Romake në vitin **476 e.s.** të çonte në vazhdimin e këtij transferimi nga ana e Perandorisë Bizantine*, këtë herë në Mesdheun Lindor.



(Fig. 37 deri në 39)
Fragmente mozaikësh, Turqi, nga e majta në të djathtë, 200-400 e.s. dhe 100-300 e.s., gur. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.

Këto portrete të ndryshme funerare (Fig. 37 deri në 39) **ilustrojnë dialogun midis kulturave**, me përshkueshmërinë* e paraqitjeve dhe praktikave artistike.

Ky relief* (Fig. 40) tregon një burrë (të vdekurin) të shtrirë mbi një divan ndërkohë që merr pjesë në një gosti, i shoqëruar nga bashkëshortja e tij, e cila është ulur pranë tij mbi jastëkë. **Kjo gosti ishte një pjesë përbërëse e ikonografisë* funerare në Palmirë, si një praktikë që ishte huazuar nga bota greko-romake**. Kjo vepër tregon **shtrirjen e Perandorisë Romake dhe përshkueshmërinë e kulturave në lidhje me ritet dhe paraqitjet e tyre**, si dhe ngjashmëritë me portretet e Fajumit për sa i përket stilit, grimit dhe stolive.



(Fig. 40) *Reliev funerar nga Palmira, Siri, 200-250 e.s., gur gëlqeror, L. 43 x Gj. 63 x Th. 18 cm. Paris, Muzeu i Luvrit. ©RMN-Grand Palais.*

EKSPLORONI MË TEJ

Për të eksploruar më tej, mund të përdorni shembujt e mëposhtëm si pika fillestare (me mundësinë për të kërkuar referenca të tjera në klasë):

SAMIA HALABY

Samia Halaby (lindur në vitin 1936), është një **piktore abstrakte palestineze** vepra e së cilës është e frymëzuar nga abstraksionet evropiane, si dhe nga paraqitjet piktoreske nga vendi i saj i lindjes, gjë e cila mund të krahasohet me shkëmbimet kulturore të diskutuara në këtë seksion. Artistja frymëzohet nga natyra dhe nga historia e artit (nga arkitektura islame e deri te avangarda sovjetike).

- Mund t'i tregoni klasës një pikturë nga Samia Halaby (të tillë si "New York" (Nju Jork), 1978, 61 x 61 cm) dhe ta diskutoni atë me klasën (kompozimi, ngjyrat, ndjesitë e shkaktuara, lidhja me titullin, emocionet etj.).

MARGUERITE JOURCENAR

Marguerite Yourcenar (1903-1987), ishte shkrimtarja e parë e zgjedhur në Académie française (Akademia Franceze), në veçanti për veprën e saj të vitit 1951 "Mémoires d'Hadrien" ("Kujtimet e Hadrianit"). Në romanin historik, ajo rrëfen për udhëtimet e **Perandorit Hadrian** (76–138 e.s.) në pushtimin e tij të Pellgut të Mesdheut, i cili mund të krahasohet me kuriozitetin dhe shkëmbimet midis kulturave të diskutuara në këtë seksion.

- Mund të lexoni një fragment nga "Mémoires d'Hadrien" (për shembull paragrafin nga kapitulli "Saeculum Aureum" i cili fillon me fjalinë "E mbajta atë pasi të tjerët shkuan [...] dhe përfundon "Zëri i tij ishte i ulët dhe greqishtja e tij kishte theksin e Azisë").

AKTIVITETI I SUGJERUAR MËSIMOR (MOSHAT 6–15 VJEÇ):

Printoni gjysmën e portretit të Fajumit me ngjyra në një fletë me format A4 dhe lëreni klasën të vazhdojë veprën, duke ndjekur vijat, ngjyrat dhe format e konkluduara. Lidhja: Portret i Fajumit (klikoni tek ikona me një shigjetë poshtë në të djathtë të portretit për të shkarkuar veprën).

Pajisjet: printer, fletë me format A4, stilolapsa me majë shajaku, lapsa me ngjyra



FJALORI

Fjalori përkufizon termat e shënuar me
yll (*) me renditjen që shfaqen në tekst

1. MESOPOTAMIA, DJEPI I QYTETËRIMIT

Qytet-shtet: në të kaluarën, një qytet-shtet ishte një territor i pavarur, i kontrolluar nga një sovran. Ai ishte pararendësi i qyteteve të sotme. **Sumerian:** populli që jetonte në Mesopotaminë Jugore midis viteve 4100 dhe 1750 p.e.s. **Priftëreshë e lartë:** në besimin fetar mesopotamik, prifti i lartë ose priftëresha e lartë kujdesej për administrimin e tempujve (shtëpitë e hyjnive) dhe bënte sakrifica të përditshme në nder të hyjnive etj.

Sin: perëndia e hënës në mitologjinë sumeriane. **Ur:** një nga qytetet më të vjetra dhe më të rëndësishme të Mesopotamisë së lashtë (Tell el-Mukajari i sotëm në Irak). **Autobiografi:** zhanër letrar dhe artistik në të cilin një individ jep përshtypjet për jetën e vet. **Metaforik:** që lidhet me një metaforë, d.m.th. një imazh ose analogji (krahasim) e përdorur për një qëllim poetik. **Priftëror:** që lidhet me priftërinë ose me priftërinj dhe priftëresha specifike. **Enki:** Perëndi sumeriane e ujërave të pijshëm dhe të rrjedhshëm, e pjellorisë dhe e diturisë. **Ninmah:** Perëndeshë që mori pjesë me bashkëshortin e saj, perëndinë Enki, në krijimin e njerëzimit, sipas shkrimeve sumeriane. **Akadian:** populli që jetoi në Akad, një mbretëri mesopotamike e themeluar nga Mbreti Sargon (babai i Enheduanës) rreth viteve 2325–2190 p.e.s. **Asimilim:** në sociologji, një proces me të cilin një i huaj ose një pakicë integrohet në një grup shoqëror më të gjerë duke përvetësuar karakteristikat e tij kulturore. **Arbelë:** qytet i lashtë akadian në Mesopotami.

2. SHPIKJA E PAPIRUSIT DHE PËRDORIMET E TIJ TË NDRYSHME NË LASHTËSI

Papirusë: shumësi i fjalës "papirus", që përdoret vetëm për dorëshkrimet e lashta. **Arie:** term kuptimi fillestar i të cilit është çdo melodi shprehëse, shpesh e kënduar. **Tragjedi:** zhanër teatral me zanafillë në Greqinë e lashtë, që karakterizohet nga gjuha e rënduar dhe një grup veprimesh që çojnë në vdekjen e një ose disa prej personazheve të saj. **Medea:** një personazh nga mitologjia greke, Medea luajti një rol vendimtar në mitin e argonautëve (ajo ndihmoi Jasonin, heroin e argonautëve, në kërkimin e tij të Bashkës së Artë). **Karkinos i Riu:** poet tragjik athinas që jetoi rreth viteve 380/360 p.e.s. **Memfis:** i themeluar rreth vitit 3100 p.e.s. dhe i ndodhur në jug të Nilit, Memfisi ishte kryeqyteti i parë i Egjiptit të lashtë (deri në vitin 2040 p.e.s.). **Euripidi:** lindur në vitin 480 p.e.s. dhe i vdekur në vitin 406 p.e.s., Euripidi ishte një prej tre tragjedianëve të mëdhenj të Athinës klasike, së bashku me Eskilin dhe Sofokliun. **Miti i rrëmbimit të Evropës:** Evropa ishte princeshë fenikase (Libani i sotëm) të cilën e lakmonte Zeusi. Zeusi vendosi ta transformojë veten në një dem të bardhë në mënyrë që ta rrëmbente dhe të ikte me të në anën tjetër të detit. Historia e saj është burimi i mitit grek të Evropës, që shpjegon krijimin e kontinentit të Evropës kundrejt Azisë. **Himnet e Delfit:** këto janë dy kompozime muzikore që i kushtoheshin perëndisë greke, Apollonit (perëndia e arteve, këngëve, muzikës, bukurisë mashkullore dhe poezisë) që u zbuluan në vitin 1893 në Delfi, Greqi. **Monodik:** me një zë të vetëm (e kundërta e polifonikut). **Titeux:** e emërtuar sipas Auguste Titeux, i cili qëndronte pas zbulimit të statuetës. **Pan:** në mitologjinë greke, perëndia e natyrës, mbrojtësi i barinjve dhe tufave. **Nimfë:** një term i përgjithshëm për hyjnitë e mitura në mitologjinë greko-romake. **Menadë:** në mitologjinë greke, menadat janë gra që shoqërojnë procesionin e perëndisë Dionis. **Dionis:** në mitologjinë greke, Dionisi është perëndia e verës, festave dhe hardhive. **Hathor:** në mitologjinë egjiptiane, Hathori është perëndeshë e dashurisë, bukurisë, muzikës, mëmësisë dhe gëzimit. **Isis:** e paraqitur si një grua që mban një fron në kokë, në mitologjinë egjiptiane, Isis është magjistarka, bashkëshortja besnike dhe mbrojtësjë e fëmijëve. **Osiris:** në mitologjinë egjiptiane, Osiris është vëllai i Isit dhe perëndia që shpiku bujqësinë dhe besimin fetar. **Vajtim:** shprehje e dukshme e pikëllimit me zë dhe në mënyrë të zgjatur, ndonjëherë me natyrë fetare ose rituale. **Fibulë:** karficë ose kapëse metalike që përdoret për të ngushtuar veshjet. **Vuajtje:** ndjesi e një trishtimi të thellë, shqetësimi dhe dhimbjeje të shkaktuar nga një ngjarje fatkeqe. **Epitaf:** mbishkrim funerar në një gur varri ose monument funerar për të kujtuar personin e vdekur. **Tanagër:** qytet i lashtë grek ku u prodhuan shumë figurina të vogla me terrakotë midis shekujve të 6-të dhe të 3-të p.e.s. **Shumëngjyrësh:** që ka ngjyra të ndryshme (e kundërta e njëngjyrësh).

3. GRATË NË EGJIPTIN E LASHTË, MIDIS NËNSHTRIMIT DHE LIRISË

Amon: hyjni themelore në panteonin egjiptian, konsiderohej perëndia e perëndive sepse solli krijimin e botës dhe të jetës. Gjatë dinastisë së 13-të (midis shekujve të 19-të dhe 17-të p.e.s.), kulti i tij mori një rëndësi të madhe dhe u bë i gjithëpranishëm në të gjithë vendin. **Tanis:** i ndodhur në deltën e Nilit, në verilindje të Kajros, Tanisi (San el-Hagari i sotëm) ishte kryeqyteti i dinastive të 21-të dhe 22-të (rreth viteve 1069–664 p.e.s.). **Tebë:** një qytet i lashtë egjiptian që ndodhej në bregun lindor të Nilit, Teba (Luksori i sotëm) ishte kryeqytet gjatë Mbretërisë së Mesme dhe Mbretërisë së Re, si dhe qyteti kryesor i perëndisë Amon. **Hitit:** popull i antikitetit, i vendosur në Anadoll, Azia e Vogël, nga shekulli i 19-të deri në shekullin e 12-të p.e.s. Termi ka rrjedhur nga "Hati", emri i rajonit në të cilin populli hitit themeloi mbretërinë e vet kryesore. Hititët konsiderohen si paraardhësit e turqve. **Aleancë martesore:** kur një bashkim vulozet me martesë. **Beteja e Kadeshit:** një betejë e bërë midis Egjiptianëve dhe hititëve (popull i Anadollit Qendror) në shekullin e 13-të p.e.s., e konsideruar nga historianët si beteja më e madhe që përfshinte koçi në antikitet. **Martesë midis dinastive:** një praktikë ku shumë sundues të Egjiptit të lashtë u martuan me bijat e mbretërve fqinjë, në mënyrë që të siguronin paqe në vend, si dhe për të formuar aleanca. **Konkubinë:** grua që jeton me një burrë pa qenë e martuar me të.

4. QYTETËRIMI ETRUSK: NJË PORTË KULTURORE

Nekropol: grup varresh monumentale ose varresh të thjeshta, të veçanta nga vendet e adhurimit. **Transferim i teknologjisë:** transferimi nga një vend në tjetrin i njohurive, teknikave të prodhimit dhe pajisjeve të përdorura për të prodhuar një objekt. **I nënshtuar:** dikush që është nën autoritetin e një personi tjetër dhe ka një rang të ulët në hierarki. **Material arkeologjik:** të gjitha objektet e lëna nga njerëzit dhe të gjetura në një kontekst arkeologjik. **Urnë hiri:** e shënuar me simbolizëm të madh, veçanërisht në artin funerar, një urnë hiri është një enë e mbyllur që përdoret për të mbajtur hirin e një personi të vdekur dhe mund të përdoret si stoli ose e vulosur mbi një varr. **Venusi:** në mitologjinë romake, Venusi ishte perëndesha e dashurisë, joshjes dhe bukurisë femërore, që asimiloi perëndinë greke Afërdita nga shekulli i 2-të p.e.s. **Turan:** në mitologjinë etruske, Turani ishte perëndesha e dashurisë, bukurisë, pjellorisë dhe shëndetit (homologia e perëndeshës asiriane dhe babilonase Ishtar, perëndeshës sumeriane Inana, perëndeshës greke Afërdita dhe perëndeshës romake Venus). **Matronë romake:** nga latinishtja "matrona", e cila vetë rrodhi nga fjala "mater" ("nënë" në latinisht), ky term emërtonte një bashkëshorte të denjë dhe nënën e familjes. Ajo ishte personi që menaxhonte detyrat e shtëpisë, mbikëqyrte punën e skllevërve, tirrte leshin, bënte fëmijë të ligjshëm për burrin e saj dhe për atdheun e kështu me radhë. **I hyjnizuar:** kur një person, kafshë ose send është ngritur në rangun e perëndisë/perëndeshës. **Priftëreshë e Isisit:** grua që mbante pozicione fetare në shërbim të perëndeshës egjiptiane Isis, një prej perëndeshave më të rëndësishme në panteonin egjiptian dhe kulti i së cilës u përhap fillimisht në Egjipt, para se të shtrihej në të gjithë botën mesdhetare.

5. ORIGJINAT E SKULPTURËS GREKE

Periudha arkaike: në historinë e Greqisë së lashtë, periudha arkaike ishte një periudhë historike afërsisht nga shekulli i 9-të ose i 8-të p.e.s. deri në shekullin e 5-të p.e.s. **Minotaur:** në mitologjinë greke, Minotauri ishte një përbindësh hibrid (me trupin e një njeriu dhe kokën e një demi, ose gjysmë burrë, gjysmë dem) që inxhinieri Dedalus e kishte burgosur në një labirint për ta ndaluar që të hante njerëzit. **Fustan pas trupit:**

një veshje femërore, e karakterizuar nga modeli i saj i ngushtë pas trupit. **Kikladet:** arkipelag i ishujve grekë që ndodhen në Detin Egje. **Kikladik:** formë arti që lidhet me qytetërimin e Kikladeve. **I pasur:** i bollshëm. **I stereotipizuar:** i frymëzuar nga një model i ngulitur dhe pa origjinalitet ose individualitet. **Fetar:** që lidhet me fenë, kultin ose adhurimin, që ka lidhje me fetaren dhe të shenjtën. **Idhull:** objekt që paraqet një hyjni dhe që adhurohej në të njëjtën mënyrë si vetë hyjnia. **Punik:** që lidhet me kartagjenasit e lashtë, një popull i lashtë që banonte në qytetin e Kartagjenës (që ndodhet në Tunizinë e sotme). **Numidian:** grup gjuhësh që fliteshin dikur nga populli i Libisë së lashtë. **Keros:** një prej ishujve më të mëdhenj të Kikladeve të Vogla. **Pastërti:** i referohet një veprë që është bërë e pastër, nga e cila janë hequr njollat. **Dedikues:** një individ që ofron një ose disa vepra. **Hyjni mbrojtëse:** perëndia ose perëndesha mbrojtëse e një qyteti. **Bal Hamon:** në mitologjinë kartagjenase, Bal Hamon ishte një kryeperëndi të cilit i ofroheshin sakrifica. **Stap i lajmëtarit:** një shkop me dy flatra në majë dhe dy gjarpërinj të ndërthurur të mbështjellë rreth tij, që i atribuohet Hermesit në mitologjinë greke dhe Mërkurit në mitologjinë romake. **Inkrustim:** një proces zbukurimi që konsiston në krijimin e gjurmëve në një material, në të cilat futen copa të vogla të një materiali tjetër. **Të shquar:** personat situata sociale e të cilëve u jep një autoritet të caktuar. **Pubik:** që lidhet me pubisin (fryrje trekëndore në zonën nën fundin e barkut). **Malakit:** mineral me ngjyrë jeshile që përdorej gjerësisht në antikitet për të bërë tone të caktuara blu në jeshile. **Retorik:** grup procesesh që përbëjnë artin e përdorimit të gjuhës me efikasitet dhe elokuencë. **Ripikturim:** pjesë e një veprë që është ripikturuar. **Toron:** zbukurim në formë unaze që zbukuron bazën e një kolone. **Bark në formën e trungut të konit:** pjesa si kube ose e lakuar e një ene që merr formën e konit të prerë. **Vernik:** veshje vitrifikuese e aplikuar në artikujt prej qeramike për t'i bërë të shkëlqejnë dhe të mos depërtohen nga uji. **Bashkëqendrorë:** që kanë të njëjtën qendër, kur bëhet fjalë për rrathët dhe lakoret. **Kampanja:** rajon në jugperëndim të Italisë.

6. PELLGU I MESDHEUT, TOKA E PUSHTIMEVE, ALEANCAVE DHE SHKËMBIMEVE

Koloni: territor i pushtuar dhe i administruar nga një komb përtej kufijve të tij. **Romanizim:** procesi me të cilin romakët përhapën kulturën, qytetërimin dhe mënyrën e tyre të jetesës në të gjitha territoret e pushtuara. **Natyralizëm:** natyralizmi i referohet procesit artistik në të cilin artisti paraqet botën me besnikëri dhe saktësi (natyrën, kafshët, peizazhet, njerëzit etj.) pa e zbukuruar ose idealizuar. **Kryqëzim:** përzierja ose kryqëzimi i grupeve etnike, racave ose specieve. **Pasaleksandriane:** periudha që pasoi vdekjen e Aleksandrit të Madh në vitin 323 p.e.s. **Oaz:** një sipërfaqe e vogël toke e përshtatshme për bimësinë dhe banimin e njerëzve në mes të shkretëtirës dhe që ekziston falë një mase ujore në afërsi. **Qendër nevralgjike:** që ndodhet në pikën më delikate, kritike. **Kolonadë:** në arkitekturë, një varg kolonash në një ose disa rreshta, që formojnë një kompleks arkitekturor. **Frontalitet:** natyra e një objekti ose veprë që paraqitet e drejtuar përballë nga shikuesi. **Perandoria Bizantine:** Perandoria Bizantine ose Perandoria Romake Lindore, i referohet shtetit që u shfaq rreth shekullit të 4-t e.s. në pjesën lindore të Perandorisë Romake, në kohën kur Perandoria Romake u nda gradualisht në dysh. **Përshkueshmëri:** aftësia për t'u përshkuar ose ndikuar nga agjentë të jashtëm. **Reliev:** në fushën e arteve të bukura, relievi është një teknikë në të cilën një figurë zgjatet nga sipërfaqja e mjetit të tij mbështetës. **Ikonografi:** të gjitha paraqitjet e të njëjtit subjekt ose temë në veprat që i përkasin arteve pamore.

ART EXPLORA FESTIVAL



CULTURAL
ODYSSEY IN THE
MEDITERRANEAN SEA

Dokument i krijuar
nga kompania ARTORA.
Në bashkëpunim me Séréna
Eychenié (shkrimi), Baptiste
Mariat (studimi) dhe Anaïs
Golay (dizajni grafik).